



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republikof Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjeto Më/Dana 27-12-2023			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Sht./cë Prillog	Vlera Vendim
01	110/05	499	34



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12.2, shkronja d të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28, me datë 04 qershor 2008), në bazë të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5, lidhur me nenin 6, paragrafi 1, pika 1.2 në harmoni me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-092, Rregullores QRK Nr.9/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale të Qeverisë së Kosovës. Në bazë të Vendimit 01-110/05-994 të datës 28.07.2023, Vendimit 01-110/05-990 të datës 28.07.2023 të Kuvendit Komunal të Vitisë për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, procesverbalit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më datën 26.12.2023 miraton këtë:

V E N D I M

**për aprovimin e punës së komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave në fshatin
Devajë të Komunës së Vitisë**

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton aprovimin e punës së komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave në Devajë, në kohëzgjatje prej 40 viteve me mundësi vazhdimi

Neni 2

Zona Kadastrale Devajë – Komuna e Vitisë, Ngastrat kadastrale:

1. P-70101018-00098-0 (771703 m2);
2. P-70101018-00211-4 (206276 m2);
3. P-70101018-00211-2 (8142 m2);
4. P-70101018-00612-0 (4279 m2).

Totali 99.04 Ha

Pronat e destinuar të shfrytëzohen për veprimtari bujqësore.

Neni 3

Afati kohorë për fillimin e investimeve është brenda një viti, ndërsa investimet duhet të përfundojnë brenda pesë viteve. Nëse brenda pesë viteve nuk përfundojnë investimet, prona-ju merret investitorit.

Neni 4

Këtij vendimi i bashkëngjisim:

- Planin e Biznesit;
- Regjistrin e pranimi të ofertave; _____
- Regjistrin e dorëzimit të ofertave;

- Procesverbalin e Komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit; dhe
- Njoftimin publik pas hapjës së ofertës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, komisioni për dhënien në afatgjatë të pronave në fshatin Devajë të Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarëve të komisionit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi

